

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - departamenti i përgjithshëm divizioni penal.** si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri dhe sek. juridike, Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit J.Th. nga fsh, ..... komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP nr.2173-4/13 të dt.05.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.04.03.2016 praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Visar Musa, të dëmtuarit E.Th. si dhe të akuzuarit, të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari J.Th. nga fsh..... komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati A. dhe e ëma R. e gjinisë A., i martuar, baba i tre fëmijëve, punëtor roje sigurimi, i gjendje së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal .....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse më datën 22.10.2013, rreth ores 10.00 në fshatin ..... komuna Ferizaj, gjersa i dëmtuari E.Th. ishte duke i ruajtur bagëtinë, i pandehuri në shenjë revolte se ai një ditë më parë e kishte share, me një shkop të drurit e ka goditur të dëmtuarin në kokë dhe në dorën e djathtë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhe (mbrejtje) e indeve të buta të kokës, bërrylit të dorës së djathtë dhe plagë çarëse-shqyese të indeve në regjionin muror të kokës e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,

**me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4,7,17,23,41,42,43,46, 50, 51,52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurit e:

**G J Y K O N**

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njejtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

I dëmtuari E.Th., ka deklaruar se hek dorë nga kërkesa pasurore- juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/€, në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2173-4/13 të dt.0505.2014 e ka ngarkuar të pandehurin J.Th. për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPK.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 04.03.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Visar Musa, në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri J.Th., në shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenit 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë veprë është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: mendimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 22.03.2014, deklarata e të dëmtuarit e dhenë në stacionin policor me dt.22.10.2013 si dhe deklarata e të pandehurit e dt.22.10.2013, raporti i qendrës emergjente në Ferizaj nr.136076 i dt.22.10.2013 si dhe dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdojë procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 të KPRK-së, si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, se me të dëmtuarin janë pajtuar, se i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka paraqitur kërkesën pasurore-juridike, se tani kanë raporte të mira mes vete, se është hera e parë që bie ndesh me ligjin, asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra penale, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata

vlërësoi shkallen e përgjegjësise penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësise penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, te pandehurit i vërtetoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njejtën kohë urdhëron që me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të marrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale, me bindjen se në rastin konkret edhe përmesë shpalljes së dënimit dhe pa ekzekutimin e tij do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së vepres penale, shkallen e përgjegjësise penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari E.Th., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se hek dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/€, në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi të marr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, P.nr.505/14, dt.04.03.2016**

**Sekretarja Juridike ,**  
Drita Ujupi

**Gjyqtari,**  
Mustaf Tahiri

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.